



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АКАДЕМИЈА ЗА СУДИИ И ЈАВНИ ОБВИНИТЕЛИ
ПАВЕЛ ШАТЕВ

KËSHILLIM ME TEMË:

**„Unifikimi i strukturës dhe cilësisë së
raporteve vjetore të gjykatave “**

Shkup

27 mars 2024

Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik

Pavell Shatev

GRUPI SYNUES I PJEËMARRËSVE





РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АКАДЕМИЈА ЗА СУДИИ И ЈАВНИ ОБВИНИТЕЛИ
ПАВЕЛ ШАТЕВ

Këshillimi është i dedikuar për zyrtarët e gjykatave nga të gjitha gjykatat në RMV.

PASQYRË E SHKURTËR DHE OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT

Unifikimi i strukturës dhe cilësisë së raporteve vjetore të gjykatave është i një rëndësie të veçantë sepse përmes raporteve prezantohet puna e gjykatave. Raportet e unifikuara duhet të mundësojnë krahasimin e punës në gjykata dhe paraqitjen e vëllimit të lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura në bazë të të cilave do të krijohen politika në të ardhmen në lidhje me planifikimin e numrit të gjykatësve dhe zyrtarëve gjyqësorë në gjykata.

Praktika afatgjatë e deritanishme tregon se nuk ka unifikim të raporteve, të cilat vijnë nga institucionet kompetente në gjyqësor dhe as metodologji që do të mundësojë marrjen e të dhënave dhe informacioneve përkatëse të krahasueshme për punën e gjykatave. Kjo veçanërisht i referohet vëllimit të punës në gjykata, lëndëve të mbetura nga viti paraprak, numrit të lëndëve të reja të pranuar, numrit të përgjithshëm të lëndëve në punë, sa janë zgjidhur dhe nëse numri i lëndëve të mbetura gjyqësore është zvogëluar ose rritet dhe kohëzgjatja e procedurave gjyqësore.

Kjo është arsyeja pse, përmes analizës së instrumenteve të përdorura nga Këshilli i Evropës (CEEPEJ) dhe Bashkimi Evropian (EU Justice Scoreboard) për të matur efikasitetin e gjyqësorit, nevoja për të ndryshuar mënyrën e matjes së cilësisë dhe vlerësimit të tregohet funksionimi i gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe harmonizimi i tyre me instrumentet e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Këto instrumente përfaqësojnë mjete informacioni që synojnë të ndihmojnë vendet anëtare dhe vendet kandidatë të Bashkimit Evropian që të perceptojnë më mirë pozicionin e tyre në krahasim me vendet e tjera në drejtim të përmirësimit të efikasitetit dhe funksionimit të gjyqësorit.

MATERIALI

- Prezantime nga ligjëruesit

VENDI KU MBAHET TRAJNIMI

Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik Pavell Shatev





РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АКАДЕМИЈА ЗА СУДИИ И ЈАВНИ ОБВИНИТЕЛИ
ПАВЕЛ ШАТЕВ

Bul.Jane Sandanski nr: 12 - 1000 Shkup

PERSONI I DETYRUAR PËR ORGANIZIMIN E TRAJNIMIT

Ivana Millanoviç, Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik Pavell Shatev
Imejl adresa: Ivana.Milanovik@jpacademy.gov.mk dhe tel. 02/2401-572

LIGJËRUESIT

m-r Lidija Tanevska Jadrovska, këshilltar i pavarur gjyqësor në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut
znj.Suzana Varnalieva, administratore gjyqësore në Gjykatën Themelore Veles

AXHENDA

27 mars 2024 (e mërkurë)

- | | | |
|-------------|--|--|
| 10:00-12:00 | Unifikimi i strukturës dhe cilësisë së raporteve vjetore të gjykatave <ul style="list-style-type: none">Pyetje dhe diskutim | m-r Lidija Tanevska Jadrovska ,
Gjykata Supreme e RMV-së |
| 12:00-12:30 | Pauzë | |
| 12:30-14:45 | Unifikimi i strukturës dhe cilësisë së raporteve vjetore të gjykatave <ul style="list-style-type: none">Pyetje dhe diskutim | znj. Suzana Varnalieva ,
Gjykata Themelore Veles |
| 14:45 | Plotësimi i pyetësorit për vlerësimin e trajnimit | |

